REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1- 180/ 8875
Nr. i faq. 10
Data 09 / 11 / 2026

Republika E Kosovës – Republika Kosova – Rëpublic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 001/08
Datë: 09.11.2026

Duke u bazuar në nenet 77, 78 paragrafi 2, 79 paragrafi 1, 80, 81 dhe 82 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Nenet 7 dhe 8 të Rregullores (QRK) Nr. 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, si dhe në kërkesën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të date 09.11.2026, Zyra e Personelit e Komunës së Junikut:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Titulli i vendit të punës: Logoped/e

Koeficienti/Paga dhe klasa: H17- koeficienti – 6.40

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i kërkuar : 1 (një)

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudha e kontratës: Me kohë të Pacaktuar

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) muaj

Institucioni: Komuna e Junikut – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vendi i Punës : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Afati për aplikim: 10.11.2026 – 09.12.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ofron shërbime të vlerësimit të zhvillimit gjuhësor dhe komunikimit te fëmijët 0–6 vjeç, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, përmes instrumenteve të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë.

2. Kontribuon në zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve për Familjen (PIShF) për fëmijët që kualifikohen për shërbime të NFH-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit.

3. Ofron shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët 0–6 vjeç në mjediset natyrore të fëmijës, të përqendruara te familja, të cilat mbështesin, zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë që lidhen me komunikimin pranues dhe ekspresiv, artikulimin gjuhësor, si dhe ushqyerjen dhe përtypjen.

4. Monitoron, dokumenton dhe raporton për progresin e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e NFH-së, si dhe kontribuon në rishikimin e rregullt të PIShF-së.

5. Ofron këshilla dhe konsulta të individualizuara për prindërit lidhur me mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve 0–6 vjeç.

6. Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimeve dhe përfaqësues të institucioneve për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

7. Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

Kualifikimi i kërkuar:

- Diplomë universitare në drejtimin Logopedi (të noterizuar).
- Licencë pune valide nga Oda e Infermiereve të Kosovës.
- Përvojë pune në shërbimet e logopedisë; përparësi përbën përvoja e punës me fëmijët 0–6 vjeç.

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Titulli i vendit të punës: Fizioterapeut/e

Koeficienti/Paga dhe klasa: H17 - koeficienti – 6.40

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i kërkuar: 1 (një)

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudha e kontratës: Me kohë të Pacaktuar

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) muaj

Institucioni: Komuna e Junikut – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vendi i Punës : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Afati për aplikim: 10.11.2026 – 09.12.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ofron shërbime të vlerësimit të zhvillimit fizik dhe motorik të fëmijëve 0–6 vjeç, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, përmes udhëzuesit për monitorimin e zhvillimit të fëmijës dhe instrumenteve të tjera të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Kontribuon në zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve për Familjen (PIShF) për fëmijët që kualifikohen për shërbime të NFH-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit.
3. Ofron shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët 0–6 vjeç në mjediset natyrore të fëmijës, të përqendruara te familja, të cilat mbështesin, zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë që lidhen me motorikën, koordinimin, balancën dhe vetëndihmën.
4. Monitoron, dokumenton dhe raporton për progresin e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e NFH-së, si dhe kontribuon në rishikimin e rregullt të PIShF-së.
5. Ofron këshilla dhe konsulta të individualizuara për prindërit lidhur me mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve 0–6 vjeç.
6. Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimeve dhe përfaqësues të institucioneve për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.
7. Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

Kualifikimi i kërkuar:

- Diplomë universitare në drejtimin Fizioterapi; në mungesë të fizioterapeutit, mund të merret në konsideratë drejtimi Ergoterapi, sipas kushteve ligjore në fuqi.
- Licencë pune valide nga organi kompetent profesional.
- Përvojë pune në shërbimet e fizioterapisë; përparësi përbën përvoja e punës me fëmijët 0–6 vjeç.

Kushtet e përgjithshme për pranim;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Titulli i vendit të punës: Psikolog/e Klinik

Koeficienti/Paga dhe klasa: H11 – Koeficienti 8.0

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i kërkuar: 1 (një)

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudha e kontratës: Me kohë të pacaktuar

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) muaj

Institucioni: Komuna e Junikut – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vendi i Punës : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Afati për aplikim: 10.11.2026 – 09.12.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ofron shërbime të vlerësimit të zhvillimit të fëmijëve 0–6 vjeç dhe mirëqenies socio-emocionale të prindërve të tyre, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, duke përdorur instrumente të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Kontribuon në zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve për Familjen (PIShF) për fëmijët që kualifikohen për shërbime të NFH-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit.
3. Ofron shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët 0–6 vjeç në mjediset natyrore të fëmijës, të përqendruara te familja, me fokus në mbështetjen e zhvillimit socio-emocional, forcimin e ndërveprimit prind–fëmijë, zhvillimin e aftësive të rregullimit emocional, sjelljeve adaptive dhe aftësive të komunikimit.
4. Monitoron, dokumenton dhe raporton për progresin e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e NFH-së, si dhe kontribuon në rishikimin e rregullt të Planit Individual të Shërbimeve për Familjen.
5. Ofron këshilla dhe konsulta të individualizuara për prindërit lidhur me mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve 0–6 vjeç.
6. Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimeve dhe përfaqësues të institucioneve për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.
7. Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

Kualifikimi i kërkuar:

- Diplomë Universitare në drejtimin Psikologji Klinike (të noterizuar) .
- Të ketë Licencë pune valide nga Oda e Infermierëve të Kosovës.
- Përvojë pune në shërbimet e psikologjisë klinike; përparësi përbën përvoja e punës me fëmijët 0–6 vjeç.

Kushtet e përgjithshme për pranim;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Titulli i vendit të punës: Punëtor/e Social/e

Koeficienti/Paga dhe klasa: GJ37 - Koeficienti – 5.90

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i kërkuar: 1 (një)

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudha e kontratës: Me kohë të pacaktuar

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) muaj

Institucioni: Komuna e Junikut – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vendi i Punës : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Afati për aplikim: 10.11.2026 – 09.12.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Planifikon dhe koordinon punën e ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme (NFH) për realizimin e vlerësimeve për fëmijët 0–6 vjeç, duke përfshirë caktimin e anëtarëve të ekipit dhe bashkëpunimin me familjen për përcaktimin e kohës së vlerësimeve.
2. Informon familjet lidhur me shërbimet e NFH-së dhe mënyrat e ofrimit të këtyre shërbimeve.
3. Koordinon dhe mbështet zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve për Familjen (PIShF), duke caktuar ofruesin primar të shërbimit për secilën familje dhe duke siguruar që modeli i shërbimit i bazuar në familje dhe i integruar në rutinat e fëmijës reflektohet në PIShF.
4. Shërben si pikë kontakti për familjet që marrin shërbime të NFH-së, duke siguruar që familjet i pranojnë shërbimet në përputhje me PIShF.
5. Informon familjen për shërbimet e disponueshme jashtë institucionit, duke përfshirë referimin në këto shërbime.
6. Bashkëpunon me shërbimet mjekësore, sociale dhe ato të edukimit për të siguruar referimin me kohë të fëmijëve 0–6 vjeç.
7. Kontribuon në hartimin e planit të tranzicionit së bashku me familjen dhe mjekun familjar, respektivisht ofruesin e shërbimit, për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve që marrin shërbime të NFH-së në institucionet parashkollore dhe arsimore.
8. Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimeve dhe përfaqësues të institucioneve për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.
9. Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

Kualifikimi i kërkuar:

- Diplomë universitare në drejtimin Punë Sociale, Sociologji ose shkenca të tjera sociale, në përputhje me kërkesat e pozitës.
- Licencë pune valide nga organi kompetent profesional, nëse kërkohet për ushtrimin e profesionit.
- Përvojë pune në shërbimet sociale; përparësi përbën përvoja e punës me fëmijët 0–6 vjeç.

Kushtet e përgjithshme për pranim;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Dokumentacioni /dëshmitë përkatëse për vlerësimin e përmbushjes se kritereve për aplikim:

1. Formulari i aplikimit i plotësuar dhe jetëshkrimi (CV);
2. Kopja e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
3. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati i përzgjedhur për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur);
4. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (prezantohet nga kandidati i përzgjedhur për emërim);
5. Dokumenti që nuk jeni i dënuar me vendim të formës së prerë (i lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se gjashtë (6) muaj);
6. Vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati, nëse përvoja e kërkuar është në sektorin publik, për të dëshmuar se nuk ka masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë të detyrave sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë;
7. Kopja e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
8. Kopja e dëshmisë së përvojës së punës;
9. Kopja e dëshmive të trajnimeve, nëse ka;
10. Kopja e licencës së punës, kur kërkohet për pozitën.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën Pritëse të Komunës së Junikut dhe duhet të dorëzohen të plotësuara, së bashku me dokumentet përcjellëse, në formë fizike.

Afati për aplikim: 10.11.2026 – 09.12.2026

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Testimi me shkrim (deri në 70 pikë)
- Intervista me gojë (deri në 30 pikë)

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet në procedur dhe shpallja e rezultateve përfundimtare :

- Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web-faqen, në linkun: https://konkursi.rks-gov.net/ e Komunës së Junikut, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe përmes telefonit mobil, pas mbylljes së konkursit.
- Për çdo paqartësi gjatë aplikimit, kandidatët mund të kontaktojnë Zyrën e Personelit .

Sqarime shtesë:

- Kandidati, përmes aplikacionit, deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara, siç kërkohet nga shpallja dhe procedura e rekrutimit.
- Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtim nga procedura e rekrutimit.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Nëse kandidati aplikon në dy e më tepër vende të punës, duhet të dorëzojë aplikacion të veçantë për secilin vend të punës.
- Komunitetet jo shumicë, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Menaxher i Personelit:
Arton Krasniqi